



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 12.09.2023

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 (paragrafi 63.1.1) të Rregullores për Prokurim Publik /Nr.001/2022, të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të 04.09.2023, të parashtruar Operatori Ekonomik “Shkelqimi Invest “SH.P.K, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Molerimi i shkollave-faza II”, me Nr. të Prokurimit: 632-23-7841-2-2-1 dhe Nr. Brendshëm 632-23-114-221.

V E N D I M

1. **Refuzohet** si e pabazuar Kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomik “Shkelqimi Invest “SH.P.K, e dt.04.09.2023, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Molerimi i shkollave-faza II”, me Nr. të Prokurimit: 632-23-7841-2-2-1 dhe Nr. Brendshëm 632-23-114-221, kundër NJOFTIMIT MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, të datës 31.08.2023, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.
2. **Vërtetohet** NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, Autoriteti
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj aktivitetin e prokurimit;
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe të publikohet në platformën elektronike të KRPP.

A r s y e t i m

Me dt.04.09.2023, Operatori Ekonomik “Shkelqimi Invest “SH.P.K., ka parashtruar Kërkesë për rishqyrtim lidhur me aktivitetin prokurimit: “Molerimi i shkollave-faza II”, me Nr. të Prokurimit: 632-23-7841-2-2-1 dhe Nr. Brendshëm 632-23-114-221.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 12.09.2023, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pretendimi juaj i parë është i pa bazuar, sepse Autoriteti Kontraktues nuk kërkon sqarime shtesë sipas nenit 72 të LPP-së, për një dokument , nëse një prej kërkesave të dosjes së tenderit nuk është plotësuar(nuk keni pasur numrin e kërkuar të stafit sipas FDT);

Pretendimi juaj i dytë gjithashtu është i pabazuar sepse ju keni prezantuar 9 punëtorë dhe 2 inxhinier, kurse në dosjen e tenderit janë kërkuar 10 punëtorë dhe dy inxhinier-staf profesional:

Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka së paku 10 (dhjetë) punëtorë të mjaftueshëm si dhe të ketë staf profesional për kryerjen e projektit a.) një inxhinier i diplomuar apo master i ndërtimtarisë - drejtimi konstruktiv me pesë vite përvojë pune pas diplomimit, b.) një inxhinier i diplomuar apo master i arkitekturës me pesë vite përvojë pune pas diplomimit.

Lista e kualifikimeve shkollore dhe profesionale të personelit tuaj profesional të dëshmohet me CV, diplomë dhe kontrata e punës apo në rast të lidhjes së kontratës mbi vepër duhet specifikuar titullin e projektit për të cilin ka lidhë kontratë, si dhe lista e numrit të punëtorëve të angazhuar me të dhënat në vijim emri, mbiemri i e punëtorit, profesioni, dhe pozicioni në kompani.

Në bazë të kësaj , siç edhe mund ta vëreni më sipër nuk është plotësuar kërkesa e FDT-së.

Nuk ju janë kërkuar sqarime shtesë për numrin e punëtorëve sepse sqarime shtesë kërkohen vetëm për dokumente ekzistenca e të cilave është fiksuar:


Sigurimi i informacionit që mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankese pranë OSHP-së . Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit të këtij vendimi.

Faton Gutaj


Menaxher i Zyrës së Prokurimit



Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit të Komunës;
Te gjitha palëve të interesuara;
Arkivit të Komunës